

URDHËR¹
Nr. 1350, datë 12.12.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME, MBI KËRKESAT
MINIMALE TË PIKAVE TË KONTROLLIT KUFITAR, PËRFSHIRË QENDRAT E
INSPEKTIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 3, neni 36, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; të ligjit nr. 105/2016, datë 27.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Ky urdhër përcakton rregullat, në lidhje me:
- a) Rregullat e përbashkëta dhe të hollësishme mbi kërkesat minimale për infrastrukturën, pajisjet dhe dokumentacionin e pikave të kontrollit kufitar dhe të pikave të kontrollit të ndryshme nga pikat e kontrollit kufitar;
 - b) Rregullat specifike dhe të hollësishme mbi kërkesat minimale për pikat e kontrollit kufitar, të përcaktuara për kategoritë e kafshëve dhe mallrave;
 - c) Rregullat e hollësishme për kërkesat minimale për qendrat e inspektimit.

Neni 2
Përkufizimet

Në kuptim të këtij urdhri, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Mallra të paketuara” – nënkupton mallrat që janë vendosur në çdo lloj ambalazhi ose material paketimi, i cili mbështjell plotësisht mallrat për të parandaluar çdo rrjedhje dhe humbje të përmbajtjes.
- 2. “Qendër inspektimi” – nënkupton një ambient të veçantë, i ngritur brenda një pike të kontrollit kufitar dhe i vendosur me qëllim kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare të kafshëve dhe mallrave, që përfshihen brenda fushës së përcaktimit të pikës së kontrollit kufitar.
- 3. “Thundrakë” – nënkupton kafshët e përcaktuara në aneksin III, të ligjit nr. 41/2025, “Për shëndetin e kafshëve”.
- 4. “Njëthundrakë të regjistruar” – nënkupton kuaj të regjistruar sipas përkufizimit të nenit 2, të urdhrit nr. 684, datë 19.12.2019, për miratimin e rregullores “Mbi kushtet mjekësore veterinare dhe të mbarështimit që zbatohen në lëvizjen dhe importin e njëthundrakëve”.

¹ Ky urdhër është përafuar me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2019/1014, të datës 12 qershor 2014, që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) 2017/625, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me përcaktimin e rregullave të hollësishme për kërkesat minimale të pikave të kontrollit kufitar, përfshirë qendrat e inspektimit, formatin, kategoritë dhe shkurtesat që duhet të përdoren për listimin e pikave të kontrollit kufitar dhe pikave të kontrollit.

Neni 3
Infrastruktura e pikave të kontrollit kufitar

1. Pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kategoritë e kafshëve dhe mallrave, kanë në dispozicion ambientet e mëposhtme:

a) zonat ose dhomat ku shkarkohen kafshët dhe mallrat, mbulohen me çati, përveç rasteve të përmendura në pikën 4;

b) dhomat ose zonat e inspektimit kanë furnizim me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë, si dhe ambiente për larjen dhe tharjen e duarve;

c) zonat ose dhomat për strehimin e kafshëve dhe zonat ose dhomat e magazinimit, duke përfshirë edhe dhomat për ruajtje në ftohje, kur është e nevojshme për kategorinë e mallrave për të cilat është përcaktuar pika e kontrollit kufitar; dhe

ç) tualete të aksesuara të cilat kanë ambiente për larjen dhe tharjen e duarve.

2. Dhomat e përmendura në pikën 1 kanë mure, dysheme dhe tavane, të cilat mund të pastrohen dhe dezinfektohen lehtësisht, me sistem kullimi të përshtatshëm dhe ndriçim natyral ose artificial të mjaftueshëm.

3. Zonat e përmendura në pikën 1, kanë mure, dysheme dhe tavane, të cilat pastrohen dhe dezinfektohen lehtësisht, me sistem kullimi të përshtatshëm dhe ndriçim natyral ose artificial të mjaftueshëm.

Kullimi i përmendur në pikat 2 dhe 3 është i përshtatshëm për të eliminuar çdo risk kontaminimi, duke mundësuar strehimin, ruajtjen, pastrimin dhe dezinfektimin në kushte të përshtatshme për kategoritë e kafshëve ose mallrave që trajtohen në zonat ose dhomat e përmendura.

4. Kërkesa që zonat e shkarkimit të jenë të mbuluara me çati, e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, nuk aplikohen në rastet e mëposhtme:

a) ngarkesa të kafshëve ujore dhe produkteve të peshkimit që nuk transportohen në kontejnerë;

b) ngarkesa të nënprodukteve shtazore jo për konsum human të përbëra nga leshti, proteina shtazore të përpunuara në sasi të mëdha – grumbull, plehu i stallës ose plehu i shpendëve –guano;

c) ngarkesa të mallrave në sasi të mëdha – grumbull, si dhe makineri të përdorura bujqësore dhe pyjore.

5. Ambientet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, nuk kërkohen për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve tjera zyrtare, si në rastet e mëposhtme:

a) Lëngjet në sasi të mëdha – grumbull, me origjinë shtazore dhe joshtazore;

b) Mallrat në sasi të mëdha – grumbull, me origjinë joshtazore, të cilat shkarkohen direkt në ambientet e magazinimit përmes përdorimit të pajisjeve të veçanta.

6. Mund të lejohet që pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kategoritë e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, përjashtohen nga plotësimi i kërkesave të mëposhtme:

a) të kenë furnizim me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë, si dhe ambiente për larjen dhe tharjen e duarve, të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1;

b) të kenë dhoma me tavane, të cilat mund të dezinfektohen lehtësisht, të përmendura në pikën 2.

7. Ambientet e përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, nuk ndahen për përdorim me kategoritë e tjera të mallrave, në rast se përdoren për produktet me origjinë shtazore dhe produktet e përbëra.

8. Ambientet e përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, nuk përdoren për ushqime me origjinë joshtazore, në rast se përdoren për produkte germinale dhe nënprodukte shtazore jo për konsum human.

9. Në përjashtim të kërkesave në pikat 7 dhe 8, pikat e kontrollit kufitar mund të ndajnë ambientet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, si në rastet e mëposhtme:

a) pikat e kontrollit kufitar, të përcaktuara vetëm për kategoritë e mallrave të paketuara; ose
b) pikat e kontrollit kufitar, të përcaktuara për kategoritë e mallrave të paketuara dhe jopaketuara, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kryen një vlerësim të riskut në pikën e kontrollit kufitar dhe provohet se mund të sigurohet shmangia e kontaminimit të kryqëzuar, si dhe nëse zbatohen masat e identifikuar në vlerësimin e riskut për parandalimin e kontaminimit të kryqëzuar; dhe

ii. nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare siguron ndarje kohore midis trajtimit të ngarkesave të ndryshme të mallrave të papaketuara, si dhe ndërmjet trajtimit të ngarkesave të mallrave të papaketuara dhe të paketuara. Gjatë periudhës së ndarjes në kohë, ambientet e përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, pastrohen dhe dezinfektohen.

10. Kërkesat e përmendura të pikës 9, nuk zbatohen për ambientet e përmendura në shkronjën “c”, të pikës 1, kur këto ambiente janë përdorur për ruajtjen e nënprodukteve shtazore jo për konsum human në sasi të mëdha – grumbull.

11. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare në pikën e kontrollit kufitar mund lejon nën kontrollin e tij, përdorimin e ambienteve për magazinimin tregtar për mallrat, me kusht që këto ambiente të jenë afër pikës së kontrollit kufitar dhe të jenë nën kompetencën e të njëjtit autoritet doganor. Këto ambiente për magazinim tregtar mund të përdoren për kryerjen e kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, si dhe mallrave me origjinë joshtazore, me kusht që këto ambiente magazinimi të përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në këtë urdhër.

12. Mallrat e ruajtura në ambientet tregtare në përputhje me pikën 11, ruhen në kushte higjienike dhe identifikohen në mënyrë të duhur, me anë të barkodeve, mjeteve të tjera elektronike ose me etiketim. Kur mallrat mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve, të kafshëve ose të bimëve, ose, në rast të organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ) dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe mjedisit, ato ruhen, gjithashtu, në një dhomë të veçantë të mbyllur me çelës, ose në zona të rrethuara dhe të ndara nga të gjitha mallrat e tjera të ruajtura në të njëjtin ambient tregtar për magazinim.

13. Nëse pika e kontrollit kufitar është e vendosur në rrugë, hekurudhë ose port, lejohet që mallrat të ruhen në mjetin e transportit me të cilin ato janë sjellë në pikën e kontrollit kufitar, nën kontrollin e autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare.

Neni 4

Pajisjet dhe dokumentacioni i pikave të kontrollit kufitar

1. Pikat e kontrollit kufitar kanë akses, në:

a) pajisje për peshimin e ngarkesave, kur përdorimi i tyre është i nevojshëm për kategoritë e kafshëve dhe mallrave për të cilat është përcaktuar pika e kontrollit kufitar;

- b) pajisje për shkarkimin, hapjen dhe inspektimin/ekzaminimin e ngarkesave;
 - c) pajisje për pastrimin dhe dezinfektimin, si dhe udhëzime për përdorimin e tyre, ose një sistem të dokumentuar të pastrimit dhe dezinfektimit kur këto shërbime ofrohen nga agjentë apo subjekte jashtë pikës së kontrollit kufitar; dhe
 - ç) pajisje të përshtatshme për ruajtjen e përkohshme të mostrave në temperaturë të kontrolluar në pritje të dërgimit të tyre në laborator, si dhe kontejnerë të përshtatshëm për transportin e tyre.
2. Dhomat ose zonat e inspektimit, kur është e përshtatshme për kategoritë e kafshëve dhe mallrave për të cilat janë përcaktuar pikat e kontrollit kufitar, pajisen me:
- a) tavolinë me sipërfaqe të lëmuar, që pastrohet dhe dezinfektohet lehtë;
 - b) termometër për matjen e temperaturës së mallrave në sipërfaqe dhe në brendësi;
 - c) pajisje për shkrirje;
 - ç) pajisje për marrjen e mostrave;
 - d) tape/shirita vulosëse dhe vulë me numra ose etiketa për markim të qartë për të siguruar gjurmueshmërinë.

Neni 5

Pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kategorinë e kafshëve

1. Përveç kërkesave të parashikuara në nenet 3 dhe 4 të këtij urdhri, pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kafshët, kanë si më poshtë:
- a) dhomë për ndërrimin e rrobave, e pajisur me dushe;
 - b) zona ose dhoma për shkarkimin e kafshëve, të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 3 të këtij urdhri, të cilat duhet të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme, ndriçim dhe ventilim të përshtatshëm;
 - c) pajisje të përshtatshme për ushqyerjen e kafshëve dhe pirje të ujit për kafshët;
 - ç) ambiente magazinimi për ushqimin e kafshëve, shtratin dhe plehun;
 - d) ambientet ose dhomat e strehimit për mbajtjen e kategorive të kafshëve për të cilat janë përcaktuar pikat e kontrollit kufitar;
 - dh) dhoma ose zona inspektimi të pajisura me pajisje kufizuese dhe pajisje tjera të nevojshme për kryerjen e ekzaminimit klinik; dhe
 - e) korsi ose korridor hyrjeje të dedikuar ose rregullime të tjera të përshtatshme, për të shmangur pritjet e panevojshme të kafshëve para se të arrijnë në zonën e shkarkimit.
2. Ambientet e përmendura në shkronjat: “b”, “c”, “d”, “dh” “e”, të pikës 1, projektohen ndërtohen, mirëmbahen dhe operojnë në mënyrë të tillë, që të shmangen lëndimet dhe vuajtjet e panevojshme të kafshëve, si dhe të garantohet siguria dhe mirëqenia e tyre.
3. Ambientet e përmendura në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, të pikës 1, përbëjnë një njësi pune të integruar dhe funksionale në tërësi.
4. Ambientet e përmendura në pikën 1, nuk përdoren për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare për ngarkesat e kafshëve që qarkullojnë dhe tregtohen brenda territorit të Republikës Shqipërisë.
- Ambientet e përmendura në pikën 1, mund të përdoren për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare mbi ngarkesat e kafshëve të destinuara për eksport nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
- a) autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kryen një vlerësim të riskut për pikat e kontrollit kufitar, duke demonstruar mënyrën se si mund të sigurohet shmangia e kontaminimit të

kryqëzuar, si dhe zbaton masat e identifikuar në bazë të vlerësimit të riskut për parandalimin e një kontaminimi të tillë; dhe

b) autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare siguron ndarje kohore, midis trajtimit të ngarkesave të kafshëve të destinuara për eksport nga Republika e Shqipërisë dhe çdo ngarkese tjetër me kafshë që hyn në Republikën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së ndarjes kohore, ambientet e përdorura për trajtimin e ngarkesave të kafshëve pastrohen dhe dezinfektohen.

5. Ambientet e përmendura në shkronjat: “b”, “c”, “d” dhe “dh”, në pikën 1, nuk përdoren për kategoritë e mallrave të tjera.

6. Vezët për çelje inspektohen në pikat e kontrollit kufitar të cilat janë të përcaktuara për kafshët.

Neni 6

Pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kategoritë e produkteve me origjinë shtazore, nënprodukteve shtazore jo për konsum human, produkteve germinale, produkteve të përbëra dhe sanës e kashtës

1. Përveç kërkesave në nenet 3 dhe 4, pikat e kontrollit kufitar të përcaktuara për kategoritë e mallrave të, kanë si më poshtë:

a) dhoma inspektimi të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, të pajisura me ambiente për të mirëmbajtur, kur është e nevojshme, një mjedis me temperaturë ambienti të kontrolluar;

b) kur ato janë përcaktuar për mallra që ruhen në temperaturë ftohjeje, ngrirjeje dhe ambienti, të jenë në gjendje t'i ruajnë njëkohësisht këto mallra në secilën kategori të përshtatshme të temperaturës, në pritje të rezultateve të analizave laboratorike, testeve ose diagnozës, ose rezultateve të kontrolleve nga autoriteti kompetent; dhe

c) dhoma për ndërrimin e rrobave.

2. Ambientet e përmendura në pikën 1, përbëjnë një njësi pune të integruar dhe plotësisht funksionale.

3. Ambientet e përmendura në pikën 1, nuk përdoren për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare mbi ngarkesat e mallrave që qarkullojnë dhe tregtohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ambientet e përmendura në pikën 1 mund të përdoren për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare mbi ngarkesat e mallrave të destinuara për eksport nga Republika e Shqipërisë vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kryen një vlerësim të riskut për pikat e kontrollit kufitar, duke demonstruar mënyrën se si mund të sigurohet shmangia e kontaminimit të kryqëzuar, si dhe zbaton masat e identifikuar në bazë të këtij vlerësimi për parandalimin e një kontaminimi të tillë; dhe

b) autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare siguron ndarje kohore, midis trajtimit të ngarkesave me kafshë të destinuara për eksport nga Republika e Shqipërisë dhe çdo ngarkese tjetër të kafshëve që hyn në Republikën e Shqipërisë. Gjatë periudhës së ndarjes kohore, ambientet e përdorura për trajtimin e këtyre dërgesave të kafshëve pastrohen dhe dezinfektohen.

4. Kërkesat e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk aplikohen për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare, mbi lëngjet me origjinë shtazore dhe joshtazore, kur këto lëngje janë në sasi të mëdha.

5. Peshqit e gjallë të destinuar për konsum njerëzor, bretkosat e gjalla të destinuara për konsum njerëzor, jovertebrorët e gjallë dhe karremat për peshkim, inspektohen në pikat e kontrollit kufitar të cilat janë caktuar për kategoritë e mallrave.

Neni 7

Kërkesat për qendrat e inspektimit

1. Pikat e kontrollit kufitar mund të përbëhen nga një ose më shumë qendra inspektimi, të cilat përdoren sipas nevojës për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktiviteteve të tjera zyrtare mbi kategoritë e kafshëve dhe mallrave, që përfshihen në fushën e veprimtarisë të pikës së kontrollit kufitar.

2. Qendrat e inspektimit duhet të përmbushin kërkesat minimale për pikat e kontrollit kufitar dhe rregullat e hollësishme mbi kërkesat minimale të këtij urdhri.

Këto kërkesa nuk zbatohen për qendrat e inspektimit që kanë akses në teknologjinë dhe pajisjet për funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Kontrollet Zyrtare (IMSOC) dhe në sisteme të tjera kompjuterike të menaxhimit të informacionit, të cilat janë të vendosura në një strukturë tjetër brenda së njëjtës pike kontrolli kufitar.

3. Qendrat e inspektimit janë:

- a) nën juridiksionin e të njëjtit autoritet doganor që mbulon pikën e kontrollit kufitar; dhe
- b) nën kontrollin e autoritetit kompetent të pikës së kontrollit kufitar.

Neni 8

Autoritetet që ngarkohen

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla